



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 25

Prishtinë, më 10 tetor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Behar Selimi, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Halit Krasniqi, Armend Zemaj, Amir Ahmeti, dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Haki Demolli, Albulena Haxhiu dhe Mufera Şinik

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumniye Murati – ZPRK, Petrit Hysaj – OSBE, Isuf Zejna – KDI, Albert Avdiu – KGJK, Astrit Hoti – KGJK, Florije Kryeziu – UNICEF/UNKT, Artan Canhasi – EULEX dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.08. 2011;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës nr. 04/L-70;
4. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-53 për Akademinë e Kosovës, për siguri publike;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-63 për hekurudhat e Kosovës;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-59 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-034 për shtetësinë e Kosovës;
8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-45 për partneritet publiko – privat;
9. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-36 për statistikën zyrtare në Republikën e Kosovës;

10. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-65 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta;
11. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L- 48 për tregti me jashtë;
12. Të ndryshme.

***Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.08. 2011

Kryetari, konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 25. 08. 2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës nr. 04/L-70

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion lidhur me këtë pikë njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës në këtë përbërje:

Amir Ahmeti, kryesues,
Armend Zemaj, anëtar dhe
Jasmina Zivković anëtar.

4. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor

Komisioni e hoqi nga rendi ditës këtë pikë.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-53 për Akademinë e Kosovës për siguri publike

Kryetari - E paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Akademinë e Kosovës, për siguri publike dhe kërkoi nga anëtarët, që të deklarohen nëse ka vërejtje për amendamentet.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-53 për Akademinë e Kosovës për siguri publike, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
 2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
 3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
- 6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-63 për hekurudhat e Kosovës**

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për hekurudhat e Kosovës. Komisioni paraqiti vërejtje në amendamentin 45.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr.04/L-63 për hekurudhat e Kosovës, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
 2. Amendamentet e Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë, përveç amendamentit 45.
 3. Komisioni për Legjislacion i sugjeron Komisionit Funksional, që ta rishikojë amendamentin 45, sepse përmbajtja e tij është e paqartë, konfuze dhe duhet të harmonizohet me Ligjin për shërbimin civil.
- 7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-59 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-034 për shtetësinë e Kosovës**

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-59 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-034 për shtetësinë e Kosovës. Komisioni paraqiti vërejtje në amendamentet 1, 2 dhe 3. Komisioni vlerësoi se me amendamentet 1, 2 dhe 3, Komisioni Funksional i ka tejkalluar autorizimet me rastin e propozimit të amendamenteve që kanë të bëjnë me dispozitat e ligjit në fuqi, që është në kundërshtim me rregullat për procedim të Projektligjit. Amendamentet e sipërpërmendura nuk janë objekt trajtimi në Projektligjin nr. 04/L-59 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-034 për shtetësinë e Kosovës. Duke u mbështetur në vlerësimet e lartpërmendura, Komisioni për Legjislacion vendosi që amendamentet 1, 2 dhe 3 t'i kthehen për rishqyrtim Komisionit Funksional.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-59 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-034 për shtetësinë e Kosovës e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
 2. Amendamentet e Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me përjashtim të amendamenteve 1, 2 dhe 3. Përmbajtja e këtyre amendamenteve i referohen neneve 2, 11 dhe 12 të ligjit bazik, dhe kjo nuk është objekt i Projektligjit dhe bie ndesh me procedurat e nismës legislative.
 3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, përveç amendamenteve 1, 2 dhe 3 mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
- 8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-45 për partneritet publiko - privat**

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për partneritet publiko-privat.

Komisioni nuk paraqiti ndonjë vërejtje në amendamente.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-45 për partneritet publiko- privat, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

9. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-36 për statistikat zyrtare në Republikën e Kosovës

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për statistikat zyrtare në Republikën e Kosovës. Komisioni nuk paraqiti ndonjë vërejtje në amendamente.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji për statistikat zyrtare në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-36, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

10. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-65 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Komisioni paraqiti vërejtje në amendamentin 3 dhe 5.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përveç amendamenteve tre (3) dhe pesë (5) .
3. Komisioni për Legjislacion i sugjeron Komisionit Funksional, që amendamenti tre (3) të riformulohet, sepse titulli i propozuar në këtë amendament është përsëritje e titullit të nënkreut D të Projektligjit, gjë që është në mospajtim me rregullat për hartimin e legjislacionit. Po ashtu, i sugjerohet Komisionit Funksional që amendamenti pesë (5) të hiqet, sepse futja e termave juridikë në gjuhën latine në tekstin e Projektligjit pa termat juridikë në gjuhën në të cilën është shkruar Projektligji, paraqet shkelje të rregullativës juridike për hartimin e legjislacionit.
4. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, përveç amendamenteve tre (3) dhe pesë (5), mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

11. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-48 për tregti me jashtë

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për tregti me jashtë. Komisioni nuk paraqiti ndonjë vërejtje në amendamente.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-48 për tregti me jashtë e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

12. Të ndryshme

- **Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike**

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për financimin e subjekteve politike. Komisioni paraqiti vërejtje në amendamentin 7.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-58 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përveç amendamentit 7. Përmbajtja e këtij amendamenti i referohet nenit 11 të ligjit në fuqi, e që kjo nuk është objekt i Projektligjit dhe bie ndesh me procedurat e nismës legislative.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, përveç amendamentit 7, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisioni

Arben Gashi